



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së	
Përmes:		
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	Datë: 11/12/2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	VI-020-917/4
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin 12 Nr.432/01-51561** për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarsvo za Finansije
Ministry of Finance

Për: Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal
Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MPI.

Kopje: Kryetari i Komunës së Gillogocit
Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPI

Përmes: Agim Krasniqi, Zv. Ministër i Ministrisë së Financave
Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave

Nga: Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave

Zyrtarët përgjegjës:
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor: Razije Murtezaj, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor: Luennije Hetemi, Departamenti i Tatimit në Pronë/Ministria e Financave

I ënda: Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Gillogocit

I loji i aktit: Vendimi 12 Nr.432/01-51561 për Caktimin e Normave Tatimore për Tatimin në pronën e Paluajtshme për Vitin 2021

I nderuar Ministër, z. Rakić,

I nderuar Sekretarë i Përgjithshëm, z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - NR. 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr.432/01-51561 datës 26.11.2020 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

I miratuar me datë: 26.11.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MPL me datë: 27.11.2020.

I dërguar për shqyrtim në MF me datë: 01.12.2020, me nr.2162.

Në shqyrtimin e përmbajtjesor të aktit, Ministria e Financave vlerëson se akti në fjalë është në përputhje me *Nenin 9 Normat Tatimore të Ligjit Nr. 06/L-005 Tatimit në Pronë*, është kompetencë e komunës të caktoj normat tatimore, andaj Vendimi i Kuvendit të Komunës së Gillogocit është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prodhon efekt juridik.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



12Nr. 432-01-51561, dt. 26.11 2020

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, si dhe në bazë të nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë, 26.11. 2020, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Gllogocit cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësiti bujqësore të parcelave-----0.15%
- Për njësiti bujqësore të objekteve-----0.15%
- Për njësiti pyjore të parcelave-----0.15%
- Për njësiti rezidenciale të parcelave-----0.15%
- Për njësiti rezidenciale të objekteve-----0.15%
- Për njësiti komerciale të parcelave-----0.16%
- Për njësiti komerciale të objekteve-----0.16%
- Për njësiti industriale të parcelave-----0.20%
- Për njësiti industriale të objekteve-----0.20%

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës,dhe zbatohet me **01.01.2021**.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj